



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



ZYRA PËR REGJISTRIMIN, CERTIFIKIMIN DHE KONTROLLIN FINANCIAR TË SUBJEKTEVE POLITIKE (Zyra) NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE (KQZ) sipas autorizimeve të dhëna me paragrafin 1 të nenit 21 dhe në përputhje me nënparagrafin 4, paragrafi 6 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike (LFSP), me datën 11.07.2024, merr këtë:

VENDIM

Për shqiptimin e gjobës për subjektin politik YENÏLIKÇI TÛRK HAREKET PARTÏSÏ

- I. Subjektit politik YENÏLIKÇI TÛRK HAREKET PARTÏSÏ, i shqiptohet gjoba në vlerë katër mijë (4,000) euro për shkeljen sipas nënparagrafit 4, paragrafi 6 i nenit 21 të LFSP.
- II. Subjekti politik YENÏLIKÇI TÛRK HAREKET PARTÏSÏ, obligohet që brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të këtij vendimi, të paguaj shumën e gjobës së shqiptuar sipas pikës I të këtij vendimi dhe të dorëzojë në Zyrës një kopje të fletëpagesës së gjobës së paguar.
- III. Me kalimin e afatit të përcaktuar në pikën II të këtij vendimi, gjobat ekzekutohen në mënyrë të detyrueshme nga Përmbartuesi Privat.
- IV. Vendimet e Zyrës për shqiptimin e gjobave hyjnë në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme

Arsyetim

Subjekti politike YENÏLIKÇI TÛRK HAREKET PARTÏSÏ, është subjekt politik i regjistruar sipas legjislacionit në fuqi nga data 29.10.2020.

Në përputhje me nenin 15 të LFSP ku theksohet qartë që raporti vjetor financiar i subjektit politik të regjistruar duhet të përmbajë kopjet e dokumentacionit mbështetës për të gjitha shpenzimet për subjektin e regjistruar politike.

Në raportin vjetor financiar të periudhës që ishte objekt auditimi, auditori ka konstatuar se subjekti politik ka deklaruar shpenzimet e qirasë në vlerë prej 1,080.00 Euro, por nuk ka prezantuar asnjë dëshmi për pagesë.

Ndërkohë, subjekti politik nuk ka ofruar asnjë dokumentacion mbështetës për të hyrat dhe shpenzimet e prezantuara për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, që ishte objekt auditimi.

Përpos shpenzimit të vlerës sipërpërmendur për qira, për shpenzimet tjera në vlerën 600 euro, subjekti politik nuk ka asnjë dëshmi, qoftë kupon fiskal ose faturë, që e vërteton shpenzimin.

Mos dorëzimi i dokumentacionit mbështetës i të gjitha të hyrave dhe shpenzimeve paraqet shkelje të nenit 15 të LFSP dhe si rezultat kjo shkelje gjohet në përputhje me nënparagrafin 4, paragrafi 6 i nenit 21 të LFSP.

Subjekti politik YENİLİKÇİ TÜRK HAREKET PARTİSİ, obligohet që pagesën ta kryejë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit për shqiptimin e gjobës përmes komunikimit zyrtar elektronik. Pagesa e gjobës duhet të dëshmohet përmes dorëzimit të kopjes së fletëpagesës në Zyrë.

Në rast të dështimit të pagesës së gjobës brenda afatit të dhënë si në pikën II të këtij vendimi, gjoba e shqiptuar ndaj subjektit politik do të ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Përmbartuesi Privat.

Nga sa u tha më lartë, Zyra vendos për shqiptimin e gjobës në vlerë prej katër mijë (4,000) euro, sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Prishtinë, 11.07.2024

Drejtori i Zyrës



Besnik Buzhala

Vendimi i dërgohet:

- Kryetari të subjektit politik YENİLİKÇİ TÜRK HAREKET PARTİSİ
- Përfaqësuesit të autorizuar financiar të subjektit politik YENİLİKÇİ TÜRK HAREKET PARTİSİ.

Këshilla juridike: Subjekti politik mund të iniciojë padi kundër vendimit të Zyrës për shqiptimin e gjobave, pranë gjykatës kompetente të shkallës së parë, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, pas njoftimit për vendimin. Inicimi i padisë nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.